



DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier
Nr 13893 Prot.
Data 03.10.2014

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE VLORE

Nr1018 Akti
Dt.regj.02.05.2014

Nr Vendimi 1209
Date 03.09.2014

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

Sot me date 03.09.2014 Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e perbere nga gjyqtari **KEN DHIMA**, asistuar nga sekretaria gjyqesore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura ceshtjen civile me **nr 1209 akti** date 02.05.2014 qe i perket:

PADITES: Klinika Miekstore "NERTILA", Lushnje me Administratore znj.Besjana Nushi, NIPTI K53822405M, me adrese , lagjja "Kongresi", Lushnje, perfaqesuar nga Klodian Hajvazi.

I PADITUR: 1- Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, ne mungese.
2- Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ne mungese.

OBJEKTI: "Kundershtim Njoftimi Vleresimit per Detyrimet Tatimore Nr. 12219/1 date 09.12.2013, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, per te paguar vleren e 295091 lekeve, lene ne fuqi me vendimin nr.425/lprot date 03.04.201 te Drejtorise se Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve."

BAZA LIGJORE: Neni 31, 32,153 e vijues dhe 324 e vijues I Kodit te Procedures Civile, Kodi Procedurave Administrative, ligji nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar. Nr.49/2012 date 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative".



Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi degjoi paditesin i cili kerkoi pranimin e padise sipas objektit dhe pasi shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi ceshtjen ne teresi, si perfundim,

VEREN

Se para Gjykates Administrative te Shkalles se pare Vlore paditesja Klinika Mieksore "NERTILA" Lushnje ka paraqitur nje padi me objekt dhe baze ligjore si me siper.

Gjykata cmon se ka juridiksion per gjykimin e kesaj ceshtjeje pasi per ceshtjen ne gjykim nuk parashikohet ne aktet ligjore e nenligjore ne fuqi ankim ne nje organ me te larte por drejtpersedrejti ne gjykate.

Gjykata cmon se kjo padi eshte ne kompetencen funksionale te kesaj gjykate konform nenit 10 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Gjykata cmon se eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate shqyrtimi i kesaj ceshtjeje pasi padia eshte nje prej atyre te parashikuara ne nenin 7 pika "ç" te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Gjithashtu gjykata cmon se eshte ne kompetencen tokesore te kesaj gjykate shqyrtimi i kesaj ceshtjeje sipas nenit 11 pika 1 te Ligjit Nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative".

Ne rastin konkret te paditur jane Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

Nga provat e administruara ne seance gjyqesore ka rezultuar se paditesja Besjana Nushi, eshte administratore e shoqerise "Klinika Nertila"sh.p.k me nr. NIPTI K53822405M, shoqeria qe ajo administron , ushtron aktivitetin ne fushen e dhenies se sherbimeve mjeksore.

Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, me shkresen nr.12219/1prot date 09.12.2013, Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore, paditesja eshte njoftuar per te paguar gjoben ne vleren e 250 000 leke, ne baze te Akt-konstatimit me Nr.0346512 date 11.11.2013.

Per kete fakt, paditesja i eshte drejtuar dhe ka kerkuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, anullimin e gjobes, por Drejtoria e Apelimit Tatimor me shkresen me nr.425/1prot date 03.04.2014 , i ka kthyer pergjigje se ka vendosur; - "Lenien ne fuqi te aktit objekt ankimi administrativ, Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore 12219/1prot date 09.12.2013, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, gjobe ne vleren e 250 000 lekeve

ne refuzimin e ankimit, per shkak se nuk jane plotesuar kerkesat e nenit 107 te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, pasi nuk eshte kryer pagesa ne vleren e 1.100 lekeve (interesa)".

Pasi paditesja ka paguar vleren e sipercituar prane Bankes se Nivelit te Dyte "Tirana Bank", bazuar ne nenin 109 pika 2 e ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Paditesja ka kerkuar nga Gjykata Administrative te anulloje keto akte te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier dhe te Drejtorise se Apelimit Tatimor:

Gjykata cmon se kjo gjobe eshte ne kundërshtim me ligjin nr. 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, per arsyet si me poshte:

Sipas organit tatimor, arsyeja e njoftim vlersimit eshte se ne shoqerine "Klinika Nertila" ne date 18/02/2013 , nga ana e inspektoreve te verifikimit ne terren, eshte mbajtur process verbali me Nr.0346513, ne te cilin eshte dokumentuar se ne kete date jane gjendur ne pune tre punojese; Blerta Tushe, Azbie Dervishi dhe Robinson Lipe.

Nga verifikimi i deklarimit elektronik te punojesve ka rezultuar se punojesja Azbie Dervishi, figuron te jete e larguar nga puna ne date 01/02/2013. Ne keto kushte bazuar ne ligjin nr.9920 date 19/05/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise"neni 119, pika 1/b nga ana e inspektorit te dosjes eshte perpiluar Njoftim Vleresimit per Detyrime Tatimore i siper permendur.

Gjate gjykimit u provua se Shoqeria "Klinika Nertila"shpk, se punonjesja Azbie Dervishi ne daten 18/02/2013 nuk eshte paraqitur ne pune si e punesuar por, si nje ish punojese, e cila po dorezonte detyren. Kjo punojese ishte vene ne dijeni , kohe me pare lidhur me faktin se ne daten 01/02/2013 do te nderpriste marredheniet financiare nga klinika e per rrjedhoje ne kete date duhej te bente dorezimet. Per kete fakt ne daten 18/02/2013 punojesja ne fjale eshte paraqitur ne klinike pikerisht per kete arsye; "Te dorezoje detyren."

Nga sa me siper rezulton se, ne daten 18/02/2013 ne klinike nuk ka patur punojese te padeklaruar, e per rrjedhoje Njoftim Vlersimi per Detyrime Tatimore, Nr.12219/1, me vlere 295.091 leke eshte i bazuar ne ligj dhe si i tille duhet te rrezohet nga Gjykata.

Gjykata cmon se conform nenit 115 i Kodit te Procedurave Administrative duhet te deklaroje relativisht te pavlefshem aktet administrative te organeve tatimore si akte ne kundërshtim me ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar si dhe te anulloje keto akte te pavlefshme.

Per sa me siper, mbi pretendimet dhe arsyetimet e dhena me lart, Gjykata cmon se duhet te vendose pranimin e kerkese-padise duke vendosur deklarimin si relativisht te pavlefshme dhe anullimin e Njoftimit te Vleresimit per Detyrimet Tatimore

Nr.12219/1 date 09.12.2013, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, per te paguar vleren e 295.091 lekeve, si dhe te vendimit nr.425/1 prot date 03.04.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve” me te cilin eshte lene ne fuqi njoftim vleresimi tatimor.

Gjykata hedh poshte pretendimet e pales se paditur si te pambeshtetura ne prova dhe ne ligj.

Konform nenit 45/b te ligjit Nr.49/2012 date 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative" qe sanksionon se:

“Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerëmë të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

Gjykata cmon se ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim dhe ai eshte i formes se prere, pasi ne rastin konkret, objekti i padise eshte me i vogel sesa njezetfishi i pages minimale ne shkalle vendi.

Per Keto Aresye

Gjykata bazuar ne nenet 31, 32,153 e vijues dhe 324 e vijues i Kodit te Procedures Civile, Kodi Procedurave Administrative, ligji nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", i ndryshuar, ligji Nr.49/2012 date 03.05.2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"

VENDOSI :

1. Pranimin e kerkesepadise si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Deklarimin si relativisht te pavlefshme dhe anullimin e Njoftimit te Vleresimit per Detyrimet Tatimore Nr.12219/1 date 09.12.2013, te Drejtorise Rajonale Tatimore Fier, per te paguar vleren e 295.091 lekeve, si dhe te vendimit nr.425/1 prot date 03.04.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve” me te cilin eshte lene ne fuqi njoftim vleresimi tatimor.
3. Urdherohet zyra e Permbarimit me ekzekutimin e ketij vendimi nga dita qe vendimi te marre forme te prere.
4. Kunder vendimit nuk lejohet ankim dhe ai eshte i formes se prere.

U shpall ne Vlore, sot me dt.03.09.2014.

SEKRETARE
KAMILA PETRITI



GJYQATAR
KENDHIMA

